



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 390/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës - Blerim Grainca nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja më datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur më 06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Blerim Grainca nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Blerim Grainca me nr. 76 të subjektit politik LDK në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit kanë konstatuar se ka fituar vota, por këto vota gjatë plotësimit të formularit nuk ju kanë shënuar fare. Parashtruesi i ankesës ka cekur se ky gabim ka ndodhë në QV. 2503D, VV. 05D dhe kërkon që ky gabim të përmisohet që sipas tij figuron edhe në rezultatin final të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit në VV 2503D/05D-Alban Baliu dhe kopjen e FRK-së.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet-Blerim Grainca të subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për votat e munguara të kandidatit në fjalë për të cilën pretendohet në ankesën e tij se i mungojnë votat e fituara në vendvotimin 2503D/05D.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është konstatuar se nga FRK-ja origjinale që gjendet në QNR janë të shënuara 20 vota lidhur me VV 2503D/05D e jo siç pretendohet në ankesë që nuk është shënuar asnjë votë në FRK.

Lidhur me pretendimin ankimor të kandidatit për deputet Blerim Grainca nga subjekti politik-LDK, se gjatë numërimit të votave në VV 2503D/05D nuk ju kanë shënuar fare votat në FRK, nuk qëndron sepse pas hetimit të FRK-së vërtetohet se i njëjti i posedon 20 vota në këtë VV.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 390/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*